

VENDIM
Nr.161, datë 7.5.1992

**PËR SHKËPUTJEN E FEDERATËS SHQIPTARE TË FUTBOLLIT NGA STRUKTURA
ORGANIZATIVE E KOMITETIT OLIMPIK E SPORTIV TË SHQIPËRISË**

Me propozimin e Komitetit Olimpik e Sportiv të Shqipërisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Federata Shqiptare e Futbollit shkëputet nga struktura organizative e Komitetit Olimpik të Shqipërisë dhe qendron në vete si person juridik.
2. Federata Shqiptare e Futbollit krijohet mbi bazën e ndarjes së strukturave ekzistuese të Komitetit Olimpik e Sportiv të Shqipërisë, në qendër e në bazë.
3. Federata Shqiptare e Futbollit është institucioni që organizon, drejton dhe kontrollon zhvillimin e veprimtarisë futbolistike të vendit tonë mbi bazën e statutit dhe të rregulloreve të miratuara nga ministri i Kulturës, i Rinisë dhe i Sporteve dhe të mbështetura edhe në rregulloren e FIFA-s dhe të UEFA-s.
4. Federata Shqiptare e Futbollit financohet pjesërisht nga buxheti i shtetit në masën që përcaktohet çdo vit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Komiteti Olimpik e Sportiv i Shqipërisë dhe Federata Shqiptare e Futbollit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi